


RAPORT VJETOR PËR VITIN 2019

**FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT**



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2019

**Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
rr. Maqedonia nr.5, 1000 Shkup**
www.fzo.org.mk

Raporti vjetor është përgatitur nga: Elena Tulevska
M-r Vladimir Dimkovski

Për përpilimin e këtij materiali kanë kontribuar po ashtu të punësuarit nga qendra e Fondit dhe të punësuarit nga njësitë rajonale të Fondit

Redaktim gjuhësor (në gjuhën maqedonase): Elizabeta Belazelkoska-Spiroska

Copyright © 2020

Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, maj 2020

CIP - Katalogimi në botim

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

35.073.52:614.2(497.7)"2019"(047)

RAPORTI vjetor për vitin 2019 / [raportin vjetor e përgatitën Elena Tulevska, Vladimir Dimkovski]. – Shkup: Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020. – 74 f. : Grafika, pamje, tabela; 28 cm.

ISBN 978-608-4695-14-1

a) Fondi i Sigurimit Shëndetësor – Maqedoni – 2019 – Raport

COBISS.MK-ID 51266821

PËRMBAJTJA

.....	3
PËRMBAJTJA.....	3
I PERSONAT E SIGURUAR	1
II SHËRBIMET SHËNDETËSORE	4
1. KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR.....	4
1.1 MJEKËT AMË	4
1.1.1 MJEKËT E PËRGJITHSHËM	4
1.1.2 GJINEKOLOGËT	7
1.1.3 STOMATOLOGËT	9
1.1.4 KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHTËPINË E SHËNDETIT	11
2. KUJDESI SHËNDETËOR SPECIALISTIK - KONSULTATIV	13
2.1 KUJDESI SHËNDETËOR SPECIALISTIK-KONSULTATIV – VEPRIMTARITË MJEKËSORE	14
2.2 KUJDES SHËNDETËOR STOMATOLOGJIK SPECIALISTIK-KONSULTATIV	17
2.3 LABORATORI.....	18
2.4 FEKONDIMI ARTIFICIAL BIOMJEKËSOR (IN-VITRO)	20
2.5 DIALIZA.....	21
3. KUJDESI SHËNDETËSOR SPITALOR	24
3.1 KOMPENSIMET E KUSHTËZUARA	29
3.2 SHËRBIMET SHËNDETËSORE KIRURGIJE – KARDIOVASKULARE.....	30
4. BARNAT	32
4.1 PËRCAKTIMI I ÇMIMEVE REFERENTE TË BARNAVE.....	37
4.2 FURNIZIMI ME BRANA QË I MBULON FSSHRMV NË NIVEL DYTËSOR DHE TRETËSOR (SEKONДАР DHE TERCJAR) TË KUJDESIT SHËNDETËSOR	38
4.3 BARNATORET	39
5. MJETE NDIHMËSE ORTOPEDIKE (PAJISJET ORTOPEDIKE)	40
6. TRAJTIMI MJEKËSOR JASHTË VENDIT	42
6.1 TRAJTIM MJEKËSOR JASHTË VENDIT ME VENDIM PREJ FSSHRMV-së	42
6.2 TRAJTIM MJEKËSOR JASHTË VENDIT PËR RASTE URGJENTE.....	43
7. E DREJTA PËR REHABILITIM MJEKËSOR SI TRAJTIM I VAZHDUAR SPITALOR	44
8. E DREJTA E REFUNDIMIT TË MJETEVE.....	45
9. E DREJTA PËR T’U LIRUAR NGA PAGESAT E PARTICIPIMIT (BASHKË-PAGESAT)	46
III KOMPENSIMET.....	48
1. E DREJTA E KOMPENSIMEVE FINANCIARE	48

1.1	E DREJTA E KOMPENSIMIT TË PAGËS GJATË PERIUdhËS SË PUSHIMIT MJEKËSOR	49
1.2	KOMPENSIMET E PUSHIMIT TË LINDJES	50
1.3	E DREJTA E UDhËZIMIT NË KOMISIONIN INVALIDOR NË RASTË TË TEJZGJATJES SË PUSHIMIT MJEKËSOR	51
IV VEPRIMTARIA E FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR		52
1. ANALIZA E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE – FINANCIARE NË FONDIN PËR SIGURIM SHËNDETËSOR PËR VITIN 2019		52
1.1	BUXHETI I FSSHRMV-së KRAHASUR ME VITET E KALUARA DHE NË RAPORT ME VENDET E TJERA	52
1.2	TË ARDHURAT	53
1.2.1	TË ARDHURAT NGA KONTRIBUTET E PAGAVE	55
1.2.2	TRASFERIMET NGA NIVELET E TJERA TË QEVERISJES	56
1.2.3	TË ARDHURA TË TJERA JO-TATIMORE (TË PA TATUESHME)	56
1.3	SHPENZIMET	57
1.4	SHPENZIMET FUNKSIONALE TË FSHRMV-së	60
2. THESARI I FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR I REPUNLKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT61		
3. PROCEDURAT JURIDIKE		62
4. MARRVESHJET NDËRKOMBËTARE TË FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR TË MAQEDONISË SË VERIUT		63
5. BURIMET NJERËZORE TË FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT		66
6. FUNKSIONI I KONTROLLIT NË FSSHRMV		66
7. PUNA E BORDIT ZGJEDHOR SI ORGAN MË I LARTË I FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT		67
8. AKTIVITETE TJERA TË FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERITU.		68
8.1	BASHKËPUNIMI ME SHOQATAT E PACIENTËVE, ODAT DHE MARRDHËNIET ME KOMUNITETIN	68
8.2	LINJA E INFORMACIONIT	69
<i>Lista e tabelave</i>		70
<i>Lista e grafikeve</i>		71

Të nderuar të siguarar,

Në vitin e kaluar 2019 kemi punuar shumë për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ju ofrojmë juve të siguararve dhe partnerëve. Në të njëjtën kohë, me fondet që kemi në dispozicion, u përpoqëm të sigurojmë sa më shumë shërbime shëndetësore për nevojat tuaja dhe të paguajmë rregullisht kompensimet e pagave.

Më poshtë në Raport janë renditur aktivitetet dhe rezultatet e punës së FSSHRMV-së gjatë vitit të kaluar 2019.

Do të ishte pothuajse e pamundur të realizohen aktivitetet e FSSHRMV-së pa përkrahjen e partnerëve tanë. Për këtë arsye, ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë punonjësit e FSSHRMV-së, si dhe për të gjithë partnerët tanë (odave, shoqatave, institucioneve shëndetësore), anëtarëve të Bordit Zgjedhor, Ministrisë së Shëndetësisë, anëtarëve të Qeverisë së RMV-së dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të tjerët që japin kontributin e tyre ashtu që FSSHRMV, të sigurojë shërbime shëndetësore për të siguararit.

FSSHRMV vazhdon synimin drejt realizimit të misionit "Fondi siguron të drejta dhe shërbime shëndetësore nga paketa themelore e shërbimeve për siguruesit mbi parimet e gjithëpërfshirëse, solidaritetit dhe barazisë".

Me respekt,

Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut është themeluar më 17 tetor 2000, në përputhje me Ligjin për sigurim shëndetësor, si institucion financiar i pavarur me të drejta dhe detyrime për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.


FSSHRM kryen veprimtari të interesit publik dhe ka autorizime publike të përcaktuara me Ligjin për Sigurim Shëndetësor.

Me Ligji për sigurim shëndetësor FSSHRMV-së i jepen të drejta, detyrime dhe përgjegjësi t'i planifikojë dhe grumbullojë mjetet që vijnë nga sigurimi i obligueshëm shëndetësor, me akte të përgjithshme ta përcaktojë mënyrën e zbatimit të së drejtës dhe detyrimeve të personave të siguruar, të paguajë shërbimet shëndetësore dhe kompensimet e pagave, të ndërmarrë masa efikase, efektive dhe ekonomike për shfrytëzimin e mjeteve financiare si dhe të drejta dhe detyrime të tjera nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.

FSSHRMV-së udhëhiqet nga Bordi Zgjedhor, si organi më i lartë dhe i vetëm drejtues, ndërsa puna e Fondit udhëhiqet nga dy drejtorë të FSSHRMV, të cilët kanë përgjegjësi të barabartë për funksionimin e FSSHRMV-së dhe për detyrimet e ndërmarra në transaksionet ligjore.

Ekzekutimi i punës së FSSHRMV-së organizohet në Zyrën qendrore me anë të 9 sektorëve dhe 30 njësiwe rajonale. FSSHRM ka hapur edhe 14 sportele të shpërndara në vend (shtet).

STRUKTURA ORGINZATIVE



VIZIONI

FSSHRMV të njihet si blerës i shërbimeve shëndetësore duke siguruar administratë efikase sa i përket të drejtës së personave të siguruar dhe shërbime shëndetësore për të cilat nënshkruan marrëveshje me institucionet shëndetësore.



MISIONI

FSSHRMV siguron të drejta dhe shërbime shëndetësore nga paketa themelore e shërbimeve për të siguruarit në bazë gjithëpërfshirëse, solidariteti dhe barazie.

I PERSONAT E SIGURUAR

Ligji për sigurimin shëndetësor i përcakton personat të cilët mund të shfrytëzojnë të drejtën e sigurimit shëndetësor. Në pajtueshmëri me ligjin, janë përcaktuar 15 kategori të siguruarish.

Numri i përgjithshëm i personave të siguruar në fund të vitit 2019 është 1.869.509, që në raport me numrin e përgjithshëm të banorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (sipas të dhënave më të fundit nga Entit Shtetëror për Statistikë), përfshin 90% të popullatës.

Tabela nr.1 Personat e siguruar

Të siguruarit	2017	2018	2019
Të punësuarit aktiv	572.291	569.618	569.616
Bujq (fermerë) aktiv	21.028	19.796	18.944
Pensionistët	304.657	312.105	324.911
Persona të papunë	6.649	4.282	4.009
Personat e siguruar përmes programit të MSH-së	246.611	247.179	250.106
Të tjerë	13.768	12.329	13.198
Të siguruarit:	1.165.004	1.165.309	1.180.784
Anëtarët e familjes:	707.462	678.784	688.725
Totali i personave të siguruar:	1.872.466	1.844.093	1.869.509

Burimi: FSSHRMV

Nga tabela nr. 1, në të cilën është paraqitur numri i personave të siguruar në periudhën 2017-2019, vërehet se numri i personave të siguruar në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 është rritur me 25.416 persona. Sipas kategorive, numri i të punësuarve në vitin 2019 arrin në 569 mijë të siguruar. Kategoria e pensionistëve është rritur për 12,8 mijë persona dhe në fund të vitit 2019 arriti në 324.911 mijë.

Numri i personave të siguruar përmes programit të Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht, atyre të cilët nuk janë të siguruar në ndonjë bazë tjetër, është 250.106 i cili në krahasim me vitin e kaluar është rritur për 2.927 persona. Rritja është për shkak të faktit se duke filluar nga viti 2015, personat me të ardhura të ulëta janë të liruar nga obligimi i regjistrimit.


Ka një rënie prej 869 personave ose 7% në kategorinë “të tjerë” dhe aty marrin pjesë të siguruarit vullnetarë, të siguruarit sipas konventës, luftëtarët nga LNÇ, personat zyrtarët fetarë, personat që pranojnë ndihmë sociale dhe personat e huaj të cilët ndjekin shkollimin në RMV. Një rënie prej 273 personave krahasuar me vitin 2018 ekziston te kategoria “personat e papunë” por që ndërkohë realizojnë të ardhura. Kategoria “buqit aktiv” krahasuar me vitin paraprak shënon rënie për 852 persona.

Numri i anëtarëve të familjes në vitin 2019 arrin në 688.725 persona dhe krahasuar me vitin e kaluar shënon rënie për 9.941 persona.

Në strukturën e personave të siguruar, 63,16% janë persona bartës të sigurimit ose persona të cilët nga të ardhurat e tyre ndajnë mjete për kontributet e sigurimit shëndetësor, ose për ata, pagesën e kontributeve të sigurimit shëndetësor e realizon ndonjë institucion ose organizatë tjetër. Pjesa e mbetur prej 36,84% janë persona të cilët, në pajtueshmëri me Ligjin për sigurime shëndetësore, janë të siguruar shëndetësorë si anëtarë të familjes, respektivisht ato janë: burri / gruaja, fëmijët deri në 18 vjeç ose deri në përfundim të shkollimit më së voni deri në moshën 26-vjeçare. Sipas shtrirjes së sistemit maqedonas, këta persona nuk paguajnë kontribute,

por kanë të drejtë të sigurimit shëndetësor përmes anëtarit të familjes së tyre i cili është bartës i sigurimit shëndetësor.


Grafiku nr.1 Të siguarit sipas strukturës



Burimi: FSSHRMV


Në strukturën e bartësve të sigurimit, pjesën më të madhe me 48,2% e përfshijnë personat e punësuar, pasuar nga pensionistët me 27,5%, të papunët dhe personat e siguar përmes Ministrisë së Shëndetësisë me 21,5%, bujqit dhe të tjerët me nga 1,6% dhe 1,1%. Kjo do të thotë se, në çdo dy persona aktiv, mesatarisht një person ka shkuar në pension dhe një person tjetër është i papunësuar, respektivisht person për të cilin sigurimin e shëndetësisë e paguan Ministria e Shëndetësisë.

Grafiku nr. 2 Bartësit e sigurimit sipas strukturës



Burimi: FSSHRMV

Grafiku nr.3 Struktura e personave të siguruar sipas rajonit



Burimi: FSSHRMV

Sipas shtrirjes rajonale të personave të siguruar, pjesa më e madhe e personave të siguruar ndodhen në rajonin e Shkupit.

Tabela nr. 2 Personat e siguruar sipas rajoneve

Rajoni	Sigurimi personal	Anëtarët	Totali i të siguruarve	Koeficienti i anëtarëve në raport me personat e siguruar personal
i Vardarit	92.034	44.916	136.950	0,49
Lindor	107.725	47.242	154.967	0,44
Jugperëndimor	111.113	68.992	180.105	0,62
Juglindor	95.164	55.282	150.446	0,58
i Pellagonisë	140.920	69.812	210.732	0,50
i Pollogut	143.020	114.849	257.869	0,80
Verilindor	89.998	57.756	147.754	0,64
i Shkupit	400.810	229.876	630.686	0,57
Total	1.180.784	688.725	1.869.509	0,58

Burimi: FSSHRMV

* Në raport janë të bashkangjitura statistikata rajonale në R. Maqedonisë së Veriut

Tabela 2, në kolonën e fundit, është paraqitur koeficienti i krahasimit mes të siguruarve dhe anëtarëve sipas rajonit (dependency rate). Ajo që vihet re është se vlera e këtij koeficienti në rajonin e Pollogut është më e larta (0.80) që tregon se numri i anëtarëve është i barabartë me numrin e bartësve, respektivisht atyre që (dhe për të cilët) paguajnë kontribute për sigurim shëndetësor. Vlera më e ulët e këtij koeficienti është në rajonin Lindor me 0,44. Në nivelin shtetëror, ky koeficient është në të njëjtin nivel me vitin 2018.

II SHËRBIMET SHËNDETËSORE

1. KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR

Në kujdesin shëndetësor parësor i siguruari e realizon kontaktin e parë me sistemin shëndetësor dhe e ka kuptimin e ashtuquajtur 'porta' e sistemit të tërësishëm. Më saktësisht, te mjeku amë secili person i siguar e meriton kujdesin e përkushtuar mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore, parashikimin e rreziqeve dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve për të ndërmarrë masa parandaluese.

Në pajtueshmëri me tekstin e lartpërmendur, FSSHRMV vazhdimisht i ndjek shërbimet shëndetësore dhe e avancojnë mënyrën e financimit të kujdesit shëndetësor parësor me qëllim që të sigurojë shërbime shëndetësore më kualitative për periudhë më afatgjate respektivisht, të sigurojë masa parandaluese dhe diagnostikim të hershëm për një mbrojtje më të mirë të shëndetit dhe mjetet të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive.

1.1 MJEKËT AMË

Personat e siguar për të shfrytëzuar kujdesin shëndetësor parësor, bëjnë përzgjedhjen e mjekut amë në këto veprimtari: mjekësinë e përgjithshme, gjinekologjinë dhe stomatologjinë e përgjithshme.

Kujdesi shëndetësor parësor i përfshin masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e mjekut të përzgjedhur, edhe atë:

- ❖ Masat parandaluese dhe aktivitetet me qëllim të përmirësimit të gjendjes shëndetësore, parandalimit, mposhtjen dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe çrregullimeve të tjera shëndetësore;
- ❖ Kontrollat mjekësore, këshillimet dhe llojet e tjera të ndihmës mjekësore me qëllim të verifikimit, kontrollimit dhe ndjekjes së gjendjes shëndetësore;
- ❖ Trajtimin e personave të sëmurë dhe të lënduarve.

Në vitin 2019, numri i përgjithshëm i marrëveshjeve të lidhura me institucionet që ofrojnë kujdesin shëndetësor parësor është 2.195, që krahasuar me vitin 2018, shënon rënie për 15 marrëveshje. Numri i përgjithshëm i mjekëve në vitin 2019 është 2.768 respektivisht, kemi një rënie prej 141 mjekësh krahasuar me 2018.

1.1.1 MJEKËT E PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2019, kujdesi shëndetësor parësor siguron gjithsej 1.445 mjekë amë të përgjithshëm. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i mjekëve të përgjithshëm amë është ulur për 104 mjekë.

Tabela nr. 3 Numri i përgjithshëm i mjekëve të përgjithshëm amë dhe numri i mjekëve në 1000 persona të siguar

Mjekët amë	Numri i mjekëve 2017	Numri i mjekëve në 100 të siguar 2017	Numri i mjekëve 2018	Numri i mjekëve në 100 të siguar 2018	Numri i mjekëve 2019	Numri i mjekëve në 100 të siguar 2019
KSHP– Mjekësi e përgjithshme	1.577	0,86	1.549	0,86	1.445	0,78

Burimi: FSSHRMV

Më poshtë, në tabelë, vërehet se numri më i madh i mjekëve amë të përgjithshëm është në rajonin e Shkupit, pra 472 mjekë, ndërsa numri më i ulët është në rajonin Lindor me 109 mjekë amë të përgjithshëm.

Tabela nr. 4 Numri i përgjithshëm i mjekëve të përgjithshëm amë dhe numri i mjekëve në 1000 të siguruar, sipas rajonit për vitin 2019

Rajoni	Mjekët e përgjithshëm	Numri i mjekëve për 100 të siguruar
i Vardarit	110	0,80
Lindor	109	0,70
Jugperëndimor	128	0,71
Juglindor	133	0,88
i Pellagonisë	155	0,74
i Pollogut	209	0,81
Verilindor	129	0,87
i Shkupit	472	0,75
Totali	1.445	0,78

Burimi: FSSHRMV

Në vitin 2019, gjithsej 1.028 marrëveshje janë lidhur me institucionet e kujdesin shëndetësor parësor për mjekësi të përgjithshme. Më poshtë, në tabelë, vërehet se numri i marrëveshjeve të lidhura krahasuar me vitin 2018 shënon rënie për 27 ISHP.

Tabela nr. 5 Numri i marrëveshjeve të lidhura në KSHP – mjekësi e përgjithshme

	2017	2018	2019
Mjekësi e përgjithshme	1.088	1.055	1.028

Burimi: FSSHRMV

Nëse krahasojmë marrëveshjet e lidhura për mjekësi të përgjithshme sipas rajonit, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, numri më i madh i marrëveshjeve të lidhura është në rajonin e Shkupit me -309 marrëveshje, që përfaqëson 30% të totalit të marrëveshjeve të lidhura në KSHP - mjekësi e përgjithshme.

Tabela nr. 6 Shpërndarja e marrëveshjeve nga KSHP - mjekësi e përgjithshme, sipas Rajonit për vitin 2019

Rajoni	Numri i marrëveshjeve	Marrëveshjet për 10.000 të siguruar
i Vardarit	75	5,48
Lindor	82	5,29
Jugperëndimor	100	5,55
Juglindor	91	6,05
i Pellagonisë	122	5,79
i Pollogut	157	6,09
Verilindor	92	6,23
i Shkupit	309	4,90
Totali	1.028	5,67

Burimi: FSSHRMV

Nëse krahasojmë numrin e të siguruarve, në çdo 10 mijë të siguruar janë të lidhura 5,67 marrëveshje të KSHP - mjekësi e përgjithshme. Numri më i madh i marrëveshjeve janë të lidhura në rajonin Verilindor me 6,23 në çdo 10 mijë persona të siguruar, ndërsa më e pak marrëveshje janë të lidhura në rajonin e Shkupit me 4,9 marrëveshje në çdo 10 mijë të siguruar.

Fondi për mjekët amë të përgjithshëm ka përcaktuar aktivitetet dhe qëllimet parandaluese të cilat janë paraqitur në tabelën më poshtë:


Tabela nr. 7 Aktivitetet preventive dhe qëllimet në KSHP - për veprimtarinë mjekësi e përgjithshme për vitin 2019

QËLLIMET PREVENTIVE TE MJEKËT AMË NGA VEPRIMTARIA MJEKËSI E PËRGJITHSHME		
QËLLIMET E PËRGJITHSHME	Receta	Shfrytëzimi racional dhe përshkrimi racional i barnave nga Lista e barnave që i mbulon FSSHRMV.
	Pushimet mjekësore	Përshkrimi racional dhe arsyeshëm i dhënies së pushimit mjekësor deri 15 ditë, nga ana e mjekut të përzgjedhur.
QËLLIME PREVENTIVE PËR PERSONAT E SIGURUAR NGA MOSHA 35 DERI 56 VJEÇARE DHE QËLLIME PËR PERSONAT ME SËMUNDJE KRONIKE TË PREKUR NGA DIABETI, SËMUNDJET E VESHKAVE DHE SËMUNDJET KARDIOVASKULARE	Preventivi i sëmundjes së sheqerit (Diabetes mellitus)	Aktivitetet preventive për zbulimin e hershëm të sëmundjes së sheqerit (Diabetes mellitus) të popullatës nga mosha 35 deri 56 vjeçare. Edukimi i të gjithë të sëmurëve të prekur nga diabeti.
	Preventivi i sëmundjeve të veshkave (nefrologjike)	Aktivitetet preventive për zbulimin e hershëm të sëmundjeve të veshkave (nefrologjike) të popullatës nga mosha 35 deri 56 vjeçare. Edukimi i të gjithë të sëmurëve të prekur nga sëmundjet e veshkave.
	Preventivi i sëmundjeve kardiovaskulare - KVP	Aktivitetet preventive për zbulimin e hershëm të sëmundjeve kardiovaskulare të popullatës nga mosha 35 deri 56 vjeçare. Edukimi i të gjithë të sëmurëve të prekur nga sëmundjet kardiovaskulare.
QËLLIME PREVENTIVE PËR TË SIGURUARIT E MITUR	Preventivi dhe zbulimi i hershëm i deformimeve të shtyllës kurrizore	Aktivitetet preventive për zbulimin e hershëm të deformimeve të shtyllës kurrizore të popullatës nga mosha 6 deri 14 vjeçare.

Burimi: FSSHRMV

Vlera e pikës së kapitationit të mjekët e përgjithshëm amë në tetor 2019 u rrit me 8 denarë dhe arriti në 63 denarë. Sidoqoftë, ai ndryshon në varësi të moshës së personit të siguruar, respektivisht personat e rinj dhe të moshuarit kanë koeficient më të lartë, siç tregohet në grafikun më poshtë. Në varësi të numrit të përgjithshëm të pikëve të mjekut amë, deri në 2500 pikë kapitationi paguhet plotësisht, për plus 500 pikët e ardhshme paguhet në vlerë prej 70%, për plus 500 pikët e ardhshme paguhet në vlerë prej 45% dhe për pikat mbi 4.500 pikë kapitation paguhet në vlerë prej 30%.

Grafiku nr. 1 Përlllogaritja e kapitationit



Burimi: FSSHRMV



Në vitin 2019, mesatarisht për kokë pacienti, mjekëve amë u është ndarë shumë vjetore prej 1.235 denarë ose nga 103 denarë në muaj. Mesatarisht, kapitali mujor i mjekut amë të përgjithshëm për vitin 2019 është 137.147.

Shuma për kapitationin e mjekëve të përgjithshëm amë në vitin 2019 është 2.378 milion denarë, e cila në krahasim me vitin 2018 është në rritje prej 10%.

Tabela nr.8 Shuma e kapitationit për mjekët e përgjithshëm

	2017	2018	2019
Mjekët e përgjithshëm	2.145.779.140	2.163.089.881	2.378.125.742

Burimi: FSSHRMV

1.1.2 GJINEKOLOGËT

Gjatë vitit 2019, kujdesi shëndetësor parësor personave të siguruar ju siguron gjithsej 151 gjinekologë. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i gjinekologëve është rritur me 7 mjekë.

Tabela nr. 9 Numri i përgjithshëm i gjinekologëve amë të regjistruar dhe numri i gjinekologëve në 1000 të siguruar

Mjekët amë	Numri i mjekëve 2017	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2017	Numri i mjekëve 2018	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2018	Numri i mjekëve 2019	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2019
KSHP - GJINEKOLOGJI	145	0,15*	144	0,16*	151	0,16*

Burimi: FSSHRMV

* të dhëna në lidhje me numrin e gjinekologëve për 1.000 të siguruara - femra

Më poshtë, në tabelë, vërehet se numri më i madh i gjinekologëve amë është në rajonin e Shkupit, përkatësisht 55 mjekë, ndërsa më i ulët është në rajonin Verilindor dhe Juglindor me 11 gjinekologë.

Tabela nr. 10 Numri i përgjithshëm i gjinekologëve amë dhe numri i mjekëve në 1000 të siguruar, sipas rajonit për vitin 2019

Rajoni	Gjinekologë	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar
i Vardarit	13	0,19
Lindor	15	0,19
Jugperëndimor	20	0,22
Juglindor	11	0,14
i Pellagonisë	13	0,12
i Pollogur	13	0,10
Verilindor	11	0,15
i Shkupit	55	0,17
Totali	151	0,16*

Burimi: FSSHRMV

* të dhëna në lidhje me numrin e gjinekologëve në 1.000 të siguruara-femra

Në vitin 2019, janë lidhur gjithsej 138 marrëveshje të kujdesit shëndetësor parësor për gjinekologët amë. Më poshtë, në tabelë, shihet se numri i marrëveshjeve të lidhura në krahasim me vitin 2018 është rritur me 3 ISHP (private).

Tabela nr. 11 Numri i marrëveshjeve të lidhura në KSHP - Gjinekologji

	2017	2018	2019
Gjinekologji	136	135	138

Burimi: FSSHRMV

Sa u përket marrëveshjeve të lidhura me gjinekologët amë sipas rajoneve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shumica e marrëveshjeve janë të lidhura në rajonin e Shkupit - 48 marrëveshje, që përfaqëson 35% të totalit të marrëveshjeve të lidhura në KSHP - gjinekologji.

Duke i krahasuar ato me numrin e grave të siguruara, në çdo 10 mijë gra të siguruara, në KSHP - gjinekologji janë lidhur 1,48 marrëveshje. Shumica e marrëveshjeve janë lidhur në rajonin Jugperëndimor – 1,97 në çdo 10 mijë gra të siguruara, ndërsa më së paku gra janë të siguruar në rajonin e Pollogut ose 0,99 për çdo 10 mijë gra të siguruara.

Tabela nr.12 Shpërndarja e marrëveshjeve të lidhura për gjinekologji sipas Rajonit për vitin 2019

Rajoni	Numri i marrëveshjeve	Marrëveshjet në 10.000 të siguruara
i Vardarit	13	1,89
Lindor	14	1,78
Jugperëndimor	18	1,97
Juglindor	10	1,32
i Pellagonisë	12	1,12
i Pollogut	13	0,99
Verilindor	10	1,33
i Shkupit	48	1,48
Totali:	138	1,48

Burimi: FSSHRMV

Fondi për gjinekologët amë ka përcaktuar aktivitete preventive dhe qëllime të paraqitura si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 13 Aktivitete dhe qëllime parandaluese në KSHP – për veprimtarinë gjinekologjia amë, për vitin 2019

QËLLIMET PREVENTIVE TE GJINEKOLOGËT AMË		
QËLLIMET E PËRGJITHSHME	Recetat	Shfrytëzimi racional dhe përshkrimi racional i barnave nga Lista e barnave që i mbulon FSSHRMV
	Pushimet mjekësore	Përshkrimi racional dhe i arsyeshëm i dhënies së pushimit mjekësor
QËLLIMET GJINEKOLOGJIKE - AKUSHERIKE	PAP - testi	Masa preventive dhe aktivitete për sëmundjet malinje në fytin e mitrës – marrja e brisqet nga PVU (Portio vaginalis uteri)
	Brisqet mikrobiologjike	Masa preventive dhe aktivitete me marrjen e brisqet për analiza mikrobiologjike
	Kolposkopi në bazë të indikacioneve pozitive të PAP-testit	Masa preventive dhe aktivitete për sëmundjet malinje – ekzaminim kolposkopi

Burimi: FSSHRMV

Shuma e pikës së kapitacionit të gjinekologët në tetor 2019 është rritur për 8 denarë dhe arrin në 63 denarë. Mesatarisht, kapitali mujor i një gjinekologu amë të regjistruar për vitin 2019 është 187.635.

Shuma e kapitacionit për gjinekologët amë në vitin 2019 është 339 milion denarë, që është një rritje prej rreth 33% në krahasim me 2018.

Tabela nr.14 Shuma e kapitacionit të gjinekologët amë

	2017	2018	2019
Gjinekologu	293.935.278	254.940.445	339.995.095

Burimi: FSSHRMV

1.1.3 STOMATOLOGËT

Gjatë vitit 2018, kujdesi shëndetësor parësor siguron gjithsej 1.172 stomatologë amë. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i stomatologëve ka rënë për 44 mjekë.

Tabela nr. 15 Numri i përgjithshëm i stomatologëve të regjistruar dhe numri i mjekëve në 1000 të siguruar

Mjeku amë	Numri i mjekëve 2017	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2017	Numri i mjekëve 2018	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2018	Numri i mjekëve 2019	Numri i mjekëve në 1000 të siguruar 2019
KSHP - Stomatologjia	1.225	0,68	1.216	0,69	1.172	0,66

Burimi: FSSHRMV

Më poshtë, në tabelë, vërehet se numri më i madh i stomatologëve është në rajonin e Shkupit, pra me 330 stomatologë, ndërsa numri më i ulët është në rajonin Verilindor me 81 stomatologë. Edhe pse në rajonin e Shkupit numri i stomatologëve është më i madhi, vërehet numri më i vogël i mjekëve në 1.000 të siguruar.

Tabela nr. 16 Numri i përgjithshëm i stomatologëve amë dhe numri i mjekëve në 1000 të siguruar, sipas rajonit për vitin 2019

Rajoni	Stomatologët	Numri i mjekëve me 1000 të siguruar
i Vardarit	95	0,69
Lindor	91	0,59
Jugperëndimor	135	0,75
Juglindor	115	0,76
i Pellagonisë	175	0,83
i Pologut	150	0,58
Verilindor	81	0,55
i Shkupit	330	0,52
Totali	1.172	0,66

Burimi: FSSHRMV

Në vitin 2019 janë lidhur gjithsej 1.029 marrëveshje në kujdesin shëndetësor parësor për veprimtarinë stomatologjike. Më poshtë, në tabelë, vihet re se numri i marrëveshjeve të lidhura krahasuar me vitin 2018 është rritur me 9 ISHP (private).

Tabela nr.17 Numri i marrëveshjeve të lidhura në KSHP- stomatologji

	2017	2018	2019
Stomatologjia	1.027	1.020	1.029

Burimi: FSSHRMV

Nëse krahasojmë marrëveshjet e lidhura të stomatologëve amë nëpër rajone, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, numri më i madh i marrëveshjeve është në rajonin e Shkupit - 275 marrëveshje, të cilat përfaqësojnë 27% të totalit të marrëveshjeve të lidhura në KSHP- stomatologji.

Tabela nr.2 Shpërndarja e marrëveshjeve të lidhura për stomatologji, sipas rajonit për vitin 2019

Rajoni	Numri i marrëveshjeve	Marrëveshja në 10.000 të siguar
i Vardarit	85	6,21
Lindor	86	5,55
Jugperëndimor	125	6,94
Juglindor	96	6,38
i Pellagonisë	160	7,59
i Pollogut	134	5,20
Verilindor	68	4,60
i Shkupit	275	4,36
Totali	1.029	5,85

Burimi: FSSHRMV

Nëse e krahasojmë numrin e të siguarve, në çdo 10 mijë të siguar janë lidhur 5,85 marrëveshje në KSHP - stomatologji. Numri më i madh i marrëveshjeve të lidhur janë në rajonin e Pellagonisë – 7,59 për çdo 10 mijë të siguar, ndërsa numri më i ulët i marrëveshjeve të lidhura janë në rajonin e Shkupit me 4,36 në çdo 10 mijë të siguar.

Fondi për stomatologët amë ka përcaktuar aktivitete dhe qëllime parandaluese që janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela nr.3 Aktivitetet preventive dhe qëllimet në KSHP për veprimtarinë – stomatologji, për vitin 2019

QËLLIMET PARANDALUESE TE STAMATOLOGËT AMË		
QËLLIMET E PËRGJITHSHME	Receta	Shfrytëzimi racional dhe përshkrimi racional i barnave nga Lista pozitive e barnave që i mbulon Fondi, mesatarisht me nga 0.4 për kokë të siguarit në nivel vjetor
	Udhëzimet	Udhëzimi racional në nivel më të lartë të kujdesit shëndetësor, mesatarisht me nga 0,4 udhëzime për kokë të siguarit në nivel vjetor, përveç udhëzimeve për laboratorin biokimike, laboratorin mikrobiologjike dhe diagnostifikim të rrezeve X
	Pushimet mjekësore	Përshkrimi racional dhe i arsyeshëm i pushimit mjekësor deri 15 ditë, mesatarisht me nga 0.2 pushime mjekësore për kokë të siguarit, në nivel vjetor
QËLLIMET PARANDALUESE	Kontrollet	Zbulimi i hershëm i sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve me anë të statusit të higjienës orale
	Kontrolli i pllakës dentale dhe heqja e mbulesës së butë të dhëmbët	Kontrolli i pllakës dentale dhe heqja e mbulesës së butë të dhëmbët
	Modelimi preventiv i çarjeve të dhëmbëve	Modelimi preventiv i çarjeve të mollarit të dytë nga mosha 11 deri 13 vjeçare, tek 100% i personave të siguar

Burimi: FSSHRMV

Vlera e kapitationit në pikë te stomatologët amë në tetor të vitit 2019 është rritur për 8 denarë dhe ka arritur në 48 denarë. Mesatarisht, kapitacioni mujor i stomatologëve amë për vitin 2019 ka arritur në 51.496.

Shuma e kapitationit për stomatologët amë në vitin 2019 ka arritur 724 milion denarë, që është një rritje prej 22% në krahasim me 2018.

Tabela nr.4 Vlera e kapitationit për stomatologët amë

	2017	2018	2019
Stomatologë	687.230.065	591.278.153	724.244.669

Burimi: FSSHRMV

1.1.4 KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR NË SHTËPINË E SHËNDETIT

Shtëpitë e Shëndetit ofrojnë shërbime shëndetësore nga kujdesi shëndetësor preventiv, shërbimet nga ndihma e shpejtë dhe mjekimin në shtëpi.

Kujdesi shëndetësor preventiv në shtëpitë shëndetësore

Masat preventive dhe aktivitetet përfshijnë:

- ❖ Mbrojtja e popullatës nga efektet e dëmshme që i kanosen shëndetit;
- ❖ Zbulimi, mposhtja dhe parandalimi i sëmundjeve infektive;
- ❖ Kontrollë sistematike të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve;
- ❖ Mbrojtja e grave në lidhje me shtatzëninë, lehoninë, laktacionin dhe kontracëpsionin;
- ❖ Mbrojtja e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël;
- ❖ Mbrojtja kundër sëmundjeve të varësisë dhe
- ❖ Masa dhe aktivitete të tjera parandaluese.

Masat dhe aktivitetet kryhen sipas vëllimit dhe mënyrës së përcaktuar me program nga qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të njëjtën kohë, FSSHRMV siguron mjete për mbulimin e shpenzimeve të personelit të angazhuar në detyrë dhe shpenzime tjera të domosdoshme të cilat nuk janë të mbuluara nga mjetet e Ministrisë së Shëndetësisë, përmes vlerësimit të paketave parësore të shërbimeve shëndetësore.

Ndihma e shpejtë mjekësore dhe kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm njëzet e katër orësh

Ndihma e shpejtë mjekësore, personi i siguar e realizon nëpërmjet procedurës diagnostike dhe terapeutike të cilat janë të domosdoshme për t'iu larguar rrezikut që i kanoset drejtpërdrejt jetës dhe shëndetit të personit të siguar.

Personi i siguar ka të drejtë për një kujdes të vazhdueshëm shëndetësor njëzet e katër orësh edhe në njësitë ku nuk ka të organizuar ndihmë të shpejtë mjekësore me shërbim kujdestarie ose në njësinë organizative ekzistuese ku ekipet mjekësore nuk janë të mjaftueshëm në numër.

Shërbimet shëndetësore nga ndihma e shpejtë mjekësore dhe kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm kryhen nga të gjithë ekipet e shtëpive shëndetësore që janë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me të cilat FSSHRMV ka marrëveshje.

Veprimtaria e patronazhit dhe patronazhi polivalent

Veprimtaria e patronazhit dhe shërbimi polivalent i përfshinë këto shërbime shëndetësore:

- ❖ Vizitat e patronazhit te gratë gjatë periudhës së lindjes;
- ❖ Vizitat e patronazhit te gratë shtatzëna dhe lehonat;
- ❖ Vizitat e patronazhit tek të porsalindurit, foshnjat dhe fëmijët parashkollorë.

Këshillim

Qendrat e këshillimit në shtëpitë shëndetësore zbatojnë aktivitetet edukative - shëndetësore për të siguar mirëqenie dhe mbrojtje të qytetarëve, masa për kujdesin shëndetësor të shtatzënisë së planifikuar dhe të dëshiruar, si dhe aktivitete për promovimin e shëndetit të popullatës dhe më gjerë.

Kujdesi shëndetësor preventiv dhe vaksinimi

Ekzaminimet preventive kryhen me dinamikën që siguron ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit, zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe çrregullimeve, zbulimin e shkaqeve dhe pasojave nga kushtet patologjike dhe krijimin e bazës për sanimin dhe përmirësimin e gjendjes të vërtetuar.

Me Programin për imunizim, i miratuar nga qeveria, janë të përfshirë të gjithë fëmijët parashkollorë dhe shkollorë që i nënshtrohen imunizimit të detyrueshëm sipas kalendarit të përcaktuar për imunizim. Imunizimin e kryejnë ekipet kryhet e shtëpive shëndetësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kujdesi shëndetësor parandalues dentar

Masat preventive stomatologjike te popullata e moshës së re i përfshin masat bashkëkohore promocionale - preventive të cilat shpijnë deri në uljen e morbiditetit të sëmundjes, më së shumti të kariesit dhe të sëmundjes para-dentalë. Në këtë veprimtari përfshihen intervenimet nga stomatologjia e fëmijëve dhe stomatologjia preventive, si dhe zbulimi i hershëm i anomalive ortodontike të fëmijëve nga moshë parashkollorë dhe shkollorë. Ky lloj i shërbimeve shëndetësore realizohet nga ekipet e shtëpive të shëndetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ekipi rural

Nga viti 2014 filloi të aplikohet Projekti për vendosjen e mjekëve rural. Me këtë, personave të siguruar të cilët nuk mundën ta realizojnë të drejtën e kujdesit shëndetësor parësor në vendin ku jetojnë, u mundësohet e drejta e kujdesit shëndetësor parësor në shtëpinë e shëndetit ku realizohet veprimtaria shëndetësore e nivelit parësor, selia e së cilës gjendet në njësinë në të cilën është e përfshirë komuna e vendbanimit të personit të siguruar.

Mjeku rural në pajtueshmëri me rregulloren ligjore:

- ❖ Kryen kontrollin e pacientëve në kushte ambulante në pikat e shtëpive të shëndetit, si dhe në kushte shtëpiake;
- ❖ Kryen masa preventive dhe aktivitete të përcaktuara me programin për avancimin dhe ruajtjen e shëndetit të pacientëve;
- ❖ Përshkruan barna me recetë nga Lista e barnave të kujdesit shëndetësor parësor;
- ❖ Merr pjesë në zbatimin e formave të ekipeve në aktivitetet e kujdesit shëndetësor parësor;
- ❖ Marrja e mostrave të gjakut;
- ❖ Aplikimin e terapisë ampulare.

Për të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor për vitin 2019 të ofruara nga shtëpitë shëndetësore, FSSHRMV siguroi mjete në vlerë prej 1,3 miliardë denarë në nivel vjetor. Në tabelën më poshtë kemi paraqitur numrin e ekipeve të kujdesit shëndetësor parandalues dhe kujdesin mjekësor urgjent.

Tabela nr. 21 Ekipet nga kujdesin shëndetësor parandalues dhe ndihma e shpejtë mjekësore me mjekim shtëpiak

Paketa parësore	2017	2018	2019
Ndihma e shpejtë mjekësore	302	310	315
Mjekimi shtëpiak dhe shërbimi kujdestar	50	49	54
Kontrolli sistematik, vaksinimi dhe këshillimoret	127	120	131
Stomatologjia parandaluese	145	143	145
Stomatologjia urgjente	31	32	32
Motrat e patronazhit	356	349	353
Ekipet rurale	28	25	24

Burimi: FSSHRMV

2. KUJDESI SHËNDETËOR SPECIALISTIK - KONSULTATIV


Shërbimet shëndetësore, të cilat të siguarit i pranojnë nga nivelin sekondar dhe i referohet diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve në klinikën ambulatorë nga mjekë specialistë, përbëjnë kujdesin shëndetësor specialistik-konsultativ. Në rast se mjeku amë ka nevojë për një mendim profesional në një nivel më të lartë, sipas sistemit të udhëzimit, ai e drejton të siguarin në një nivel më të lartë te një mjek specialist. Në nivelin sekondar, të siguarit mund të marrin lloje të ndryshme të shërbimeve që grupohen sipas veprimtarive, siç janë: mjekësia e brendshme, veprimtaria laboratorike, radio-diagnostikimi, mjekësia fizike, mjekësia e syve etj. Shërbimet e këtij niveli të kujdesit shëndetësor ofrohen nga ekipe mjekësore në institucionet shëndetësore publike (ISHP) dhe institucionet shëndetësore private (ISHP).

Në vitin 2019, numri i përgjithshëm i marrëveshjeve që FSSHRMV ka lidhur me ISHP-të (private) me këtë lloj të kujdesit shëndetësor, është 412 dhe është afërsisht i njëjtë me atë të vitit 2018, si pasojë e prurjes së rritjes të institucioneve shëndetësore, respektivisht futjen e kriterëve sipas të cilave institucionet shëndetësore mund të lidhin marrëveshje me sigurimin shëndetësor të detyrueshëm. Buxheti i këtyre institucioneve shëndetësore në vitin 2019 ka pasur vlerën prej 619.5 milion denarë, dhe po këta institucione në të njëjtin vit kanë realizuar shërbime në vlerë të përgjithshme prej 1.200 milion denarë.

Bazuar në të dhënat, nga të gjitha shërbimet që ofron kujdesi shëndetësor specialistik-konsultativ, numri më i madh i të siguarve kanë pasur nevojë për shërbimet laboratorike specialiste edhe atë me 17% pjesëmarrje në shërbimet e përgjithshme të nivelit specialistik, si dhe për shërbimet e brendshme dhe ekzaminimet laboratorike që sigurohen me udhëzimin e mjekut amë – LU1 me 13%. Pasohet nga shërbimet radio-diagnostiko me 11% dhe shërbimet e mjekësisë së brendshme me 10%, pasuar nga mikrobiologjia dhe parazitologjia me 7% dhe rehabilitimi mjekësor me 4%, etj. Shërbimet e oftalmologjisë, shërbimet kirurgjikale dhe shërbimet e psikiatrisë përfaqësohen nga 3%, ORL, pediatri, neurologji me 2%, etj.

Krahasuar me vitin 2018, ka një rritje të testeve laboratorike që sigurohen me udhëzime e mjekut amë - LU1 me 3%, ndërsa në shërbimet e specializuara të veprimtarive tjera nuk ka devijime të mëdha.


Grafiku nr. 2 Struktura e faturimit të vlerave të kujdesit shëndetësor specialistik – konsultativ për vitin 2019



Burimi: FSSHRMV

Nga të dhënat e analizuara për vitin 2019, vërehet se 82% nga mjetet për kujdesin specialistik-konsultativ janë orientuar për shërbimet shëndetësore të siguruara në kuadër të shëndetit publik, ndërsa 18% nga mjetet janë orientuar për shërbimet në shëndetësinë private.

Grafiku nr. 3 Mjete për shërbimet specialiste sipas llojit të ISH



Burimi: FSSHRMV

2.1 KUJDESI SHËNDETËOR SPECIALISTIK-KONSULTATIV – VEPRIMTARITË MJEKËSORE

Përveç institucioneve shëndetësore publike, me udhëzim nga mjekët amë për nivel më të lartë të kujdesit shëndetësor, të siguruarit mund të shërbehen me shërbime shëndetësore edhe nga institucionet specialistike – konsultative private të cilat kanë marrëveshje me FSSHRMV-në.

Në vitin 2019, Fondi ka përfunduar një marrëveshje me 144 ISHP (private) që kryejnë kujdes shëndetësor specialistik - konsultativ në aktivitetet mjekësore, nga të cilat 4 janë laboratorë (LU2) dhe 1 laborator për analiza citologjike. Në të njëjtat institucione shëndetësore, shërbimet ofrohen nga gjithsej 167 ekipe.

Tabela nr. 22 Numri i marrëveshjeve në ISHP (private) – KSHK që kryejnë veprimtari mjekësore

	2017	2018	2019
ISHP (private) – KSHK veprimtari mjekësore	147	147	144

Burimi: FSSHRMV

Sa i përket shpërndarjes rajonale të ekipeve të specializuara, numri më i madh është në rajonin e Shkupit, i ndjekur nga rajoni Jugperëndimi, Verilindor dhe Lindor.

Tabela nr.5 Shpërndarja e ekipeve specialiste sipas rajonit¹

Rajoni	Dermatologjia	Mjekësi interno	Kirurgjia maksilo -faciale	Neurologjia	Kirurgjia e përgjithshme	Ortopedia	ORL	Oftalmologjia	Psikiatria	Mjekësia fizikale	Total
i Vardarit	0	7	0	0	0	0	1	1	0	0	9
Lindor	1	7	0	0	1	0	2	3	2	0	16
Jugperëndimor	0	9	0	1	0	0	1	4	1	1	17
Juglindor	1	3	0	0	0	1	0	1	2	1	9
i Pellagonisë	1	2	1	1	0	0	0	0	2	0	7
i Pollogut	0	5	1	0	0	1	1	2	1	0	11
Verilindor	2	5	0	0	0	1	4	1	2	1	16
i Shkupit	7	23	0	2	0	1	7	9	10	17	76
Totali	12	61	2	4	1	4	16	21	20	20	161

Burimi: FSSHRMV


Përcaktimi i vlerës së buxhetit në nivel vjetor për ISHP (private) që kryejnë veprimtari në kujdesin shëndetësor specialistik-konsultativ është bërë në pajtueshmëri me metodologjinë e përcaktuar në kuadër të Planit dhe programit për shërbime shëndetësore, të cilën Fondi e përcakton me kuadër të mjeteve të planifikuara financiare vjetore, sipas Ligjit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e duhur dhe proporcionale e fondeve ndërmjet ISHP-ve gjatë caktimit të buxhetit, përllogaritja bazohet në vlerë prej 72.000 denarë në muaj për çdo ekip (pragu i përcaktuar minimal për vlerën mujore të çdo ekipi) dhe analiza e shërbimeve të realizuara deri/mbi buxhetin e vitit të kaluar, merret parasysh realizimi i shërbimeve deri në tremujorin e tretë dhe projektimi deri në fund të vitit.

Në tremujorin e katërt, Fondi pa nevojën për të rritur buxhetin e marrëveshjeve, dhe kështu të njëjtat i rriti për 15% në të gjitha institucionet private të kujdesit shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësore specialistike-konsultative, një trend që vazhdoi edhe në vitin 2020. Me këtë rritje, shuma minimale për vlerën e ekipit në baza mujore është 82.800 denarë.

¹Pa laboratorin LU2 dhe citologjinë

Grafiku nr. 4 Numri i marrëveshjeve dhe buxheteve për veprimtarinë e kujdesit specialistik-konsultativ (të shprehura në milion denarë)



Burimi: FSSHRMV

Vlera totale e përfitimeve të rëna dakord në vitin 2019 për ISHP-të që kryejnë veprimtari mjekësore specialiste - këshilluese - është 219,3 milion denarë. Krahasuar me vitin 2018, mund të vërehet se numri i marrëveshjeve ka rënë ndërsa vlera është rritur si rezultat i rritjes së tarifave të kontratave për ISHP në tremujorin e 4-të të vitit 2019.

Në vitin 2019, numri i përgjithshëm i shërbimeve shëndetësore specialiste-konsultative të kryera në institucionet shëndetësore private është 700.534.

Tabela nr.6 Shërbime më të shpeshta dhe paketat specialistike të shërbimeve mjekësor në vitin 2019 në ISHP

Shifra e paketës	Përshkrimi i paketës	Numri i përgjithshëm i paketave	Vlera e përgjithshme
ASK1	Paketa specialistike bazë	167.271	63.562.980
AIM19	EHO për organet e abdomenit ose dhe të krahavorit	70.830	35.415.000
AFMA4	Paketa minimale për trajtim fizik dhe rehabilitues për 10 ditë (nga 3 deri në 5 procedura)	6.930	24.255.000
³A - Barna që veprojnë në traktin digjestiv dhe metabolizëm; B - barna që veprojnë në gjak dhe organet hemopojetike ; C - barna që veprojnë në zemrën dhe enët e gjakut; D - barnat dermatologjike; G - barna që veprojnë në traktin gjenitourinar dhe hormonin gjinor; H - barnat që veprojnë në gjëndrat me sekretim të brendshëm, me përjashtim të hormonit gjinor dhe insulinës; J - barnat anti-infektive për përdorim sistematik; L - barnat antineoplazike dhe imunosupresore; M - barnat që veprojnë në sistemin muskulo-skeletor; N-barna që veprojnë në SNQ; P - barnat për trajtimin e infeksioneve të shkaktuara nga parazitët; R - barna për trajtimin e sëmundjeve të sistemit të frymëmarrjes; S - barna që veprojnë në organet shqisore; V- barna të tjerë.

Grafiku nr. 15 Vlera e përgjithshme e barnave me receta që mbulohe nga Fondi në KSHP, sipas grupit ATC, 2017-2019



Burimi: FSSHRMV

Ka një rënie në vlerën e faturuar për barnat krahasuar me vitin 2019, edhe atë në 5 grupe të barnave. Për herë të parë në barnat që veprojnë në sistemin kardiovaskular - zemrën dhe enët e gjakut, përkundër rritjes së numrit të recetave të realizuara, shuma e faturuar në vitin 2019 u ul me 9,3%.

Ekziston një zvogëlim i vlerës së faturuar në barnat që veprojnë në organet shqisore me 0,2%, në barnat që veprojnë në SNQ me 2%, në barnat antineoplastike dhe imunomoduluese me 1,6% dhe në barnat për trajtimin e infeksioneve të shkaktuara nga parazitët 8,7%. Në grupet e tjera të barnave ka një rritje të shumës së faturuar nga barnatoret në Fond.


Shumica e fondeve janë të destinuara për barna që veprojnë në sistemin kardiovaskular - zemrë dhe enët e gjakut, sistemin e frymëmarrjes dhe sistemin nervor qendror.

Bari më i përdorur në vitin 2019, si në vitet e kaluar, është bari "enalapril" me afro 2,07 milion receta të realizuara, që është 8,5% e recetave totale të realizuara në 2019. Ky medikament bën pjesë në grupin e barnave kardiake që veprojnë në sistemin renin-angiotenzin.

Top 10-të barnat e para më të përdorura nga gjenerikët sipas numrit të recetave të realizuara në 2019 janë të njëjtat që ishin më të përdorurat në 2018, me përjashtim të rosuvastatinës gjenerike e cila, ndryshe nga viti i kaluar, tani hyn në 10 barnat më të përdorura.

Top 10-të barnat kryesore më të përdorura sipas numrit të recetave të realizuara zënë rreth 42,6% të numrit të përgjithshëm të recetave të realizuara në 2019.

Grafiku nr. 16 Dhjetë barnat më të përdorur në KSHP për vitin 2019




Burimi: FSSHRMV

Sipas vlerës së përgjithshme të faturuar në dy vendet e para marrin pjesë barnat për terapi kardike që ulin nivelin e lipideve në gjak. Bari “rosuvastatin” zë vendin e parë dhe në vitin 2019 përafërsisht 139 milion denarë u faturuan për të. Në vendin e dytë në vitin 2019, sipas vlerës së përgjithshme të faturuar prej 131 milion denarë është “atorvastatina gjenerike”, e cila në 10 vitet e kaluara ishte në vendin e parë. Në të dy gjenerikët ka një rënie të vlerës së përgjithshme të faturuar prej 2,34%, për “rosuvastatin”, dmth me 11,5% te gjeneriku atorvastatinës, krahasuar me vitin paraprak. Këto dy barna zënë 9,6% të shumës totale të faturuar për barnat me recetë në 2019.

Top 10-të barnat kryesore sipas shumës totale marrin pjesë me 36,2% në sasinë totale të barnave për vitin 2019.

Grafiku nr. 17 Top 10 barnat kryesore sipas shumës totale të faturuar në KSHP për vitin 2019




Burimi: FSSHRMV

4.1 PËRCAKTIMI I ÇMIMEVE REFERENTE TË BARNAVE

Çmimet referente (kompensimet) të barnave nga Lista e barnave që mbulon FSSHRMV përcaktohen dhe azhurnohen në pajtueshmëri me rregullat ligjore për barnat me qarkullim të aprovuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes procedurës së përshkruar ligjore dhe me një metodologji krahësuese të Fondit bazuar në çmimet krahësuese të barnave në vendet referuese të rajonit (Sllovenia, Sërbia, Kroacia, Bullgaria) dhe çmimet e vetme të miratuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2019, prej gjithsej 401 barna me emër gjenerikë nga lista pozitive parësore, me çmime referente (me emër të përgjithshëm me formë dhe forcë), rreth 67 % janë barna për të cilat kompanitë farmaceutike kanë mundësura çmimime që ato barna të sigurohen pa kosto shtesë për të siguruarit e Fondit

Grafiku nr. 18 Krahasimi i barnave sipas gjenerikës me çmime referente për KSHP, me dhe pa kosto shtesë



Burimi: FSSHRMV


Numri i barnave sipas emërimit të mbrojtur nga lista pozitive parësore, për të cilat Fondi ka përcaktuar çmime referente në vitin 2019 është 971 barna. Një ndër qëllimet kryesore të Fondit është të sigurojë sa më shumë barna pa kosto shtesë për të siguruarit. Kostoja shtesë paraqet dallimin mes çmimit të barit që e ka përcaktuar Ministria e Shëndetësisë gjegjësisht çmimit të përcaktuar nga prodhuesi dhe çmimi referent të barit me emër gjenerikë me fortësi dhe formë dozimi, i cili përcaktohet nga FSSHRMV.

Struktura e barnave sipas koston shtesë në vitin 2019 është si në vijim:

- ❖ Barna pa kosto shtesë me emër të mbrojtur nga prodhues të ndryshëm janë 36,4% nga numri i përgjithshëm i barnave me recetë që i mbulon FSSHRMV në KSHP;
- ❖ Me kosto shtesë prej 100 denarë janë afërsisht 45,3% prej barnave me çmime referente;
- ❖ Me kosto shtesë prej 100 deri në 500 denarë janë 16.4% barna dhe
- ❖ Minimumi 2% janë barna me kosto shtesë mbi 500 denarë, për të cilat sigurohen barna të tjera të së njëjtës gjenerike që janë falas.

Më poshtë është paraqitur grafiku me krahasimet e kostove shtesë të barnave me emër të mbrojtur për vitin 2019.

Grafiku nr. 19 Kostoja shtesë e barnave me emër të mbrojtur në KSHP, për vitin 2019.



Burimi: FSSHRMV


4.2 FURNIZIMI ME BRANA QË I MBULON FSSHRMV NË NIVEL DYTËSOR DHE TRETËSOR (SEKONDAR DHE TERCIAR) TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

FSSHRMV është një blerës i shërbimeve shëndetësore në çmimin e të cilave përfshihen edhe barnat. Furnizimi me barna i institucioneve të kujdesit shëndetësor në nivelin sekondar dhe terciar të kujdesit shëndetësor realizohet drejtpërdrejt nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë në RMV, përmes procedurave për furnizime publike dhe çmimet e tyre nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë si shpenzime të të siguruarve.

Për kujdesin shëndetësor spitalor, në vitin 2019 nga Lista e barnave që barten nga Fondi me një çmim referimi të përcaktuar janë gjithsej 332 barna gjenerike me një formë të caktuar dozimi farmaceutik dhe vëllimi.

Në vitin 2019, sipas të dhënave që i siguron departamenti i thesarit, institucionet shëndetësore publike shpenzuan rreth 4,9 miliardë denarë për barna, që krahasuar me vitin 2018, vërehet një rritje prej rreth 9%.

Grafiku nr. 20 Shpenzimet e ISHP-ve (publike) për barnat dhe materialet mjekësore në periudhën 2016-2019




Burimi: FSSHRMV

4.3 BARNATORET

Për dhënien e barnave nga lista parësore e barnave, FSSHRMV lidh marrëveshje me barnatoret. Në vitin 2019, FSSHRMV ka lidhur marrëveshje me 771 njësi pune prej të cilave 74 janë stacione farmaceutike, 7 janë barnatore mobile dhe 2 janë barnatore rurale.

Nga grafiku në vazhdim mund të vërehet se numri i këtyre marrëveshjeve brenda periudhës 5 vjeçare është rritur për 8% ose për 54 barnatore.

Grafiku nr. 21 Numri i marrëveshjeve të lidhura me barnatoret në periudhën 2014– 2019



Burimi: FSSHRMV

Në tabelën më poshtë mund të vërehet se numri më i madh i marrëveshjeve të lidhura me barnatoret është në rajonin e Shkupit me 225 barnatore, ndërsa numri më i ulët i marrëveshjeve të lidhura është në rajonin Verilindor me 54 barnatore.

Tabela nr.21 Numri i marrëveshjeve me barnatoret për vitin 2019

Rajoni	Numri i barnatoreve	Numri i barnatoreve 10.000 të siguruar
i Vardarit	63	4,60
Lindor	71	4,58
Jugperëndimor	79	4,39
Juglindor	76	5,05
i Pellagonisë	114	5,41
i Pollogut	89	3,45
Verilindor	54	3,65
i Shkupit	225	3,57
Totali	771	4,34

Burimi: FSSHRMV

Nëse krahasojmë numrin e të siguarve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në çdo 10.000 të siguar ka nga 4,34 barnatore, ndërsa nëse krahasojmë me mesataren në Evropë është 3,03 barnatore në 10.000 banorë. Sipas rajonit, numri më i madh i barnatoreve është në rajonin e Pellagonisë 5,41 në 10.000 të siguar, ndërsa numri më i vogël është në rajonin e Pollogut 3,45 barnatore në 10.000 sigurues.

Mjetet e përgjithshme për barnat në vitin 2019 janë në vlerë prej 3,05 miliard denarë. Fondin në periudhën vjetore paraprake financoi këto institucione shëndetësore duke përcaktuar një shumë mujore të fondeve (kuotave).

Në mënyrë që të sigurojmë plotësisht barnat me recetë që paguhen nga Fondi, dhe duke pasur parasysh që për shumë vite ishte një problem për siguresit tanë, për shkak të ekzistencës të kuotave të barnatoreve, në tetor të vitit 2019 Fondi mundëson heqjen e plotë të kuotave.

5. MJETE NDIHMËSE ORTOPEDIKE (PAJISJET ORTOPEDIKE)

Personat e siguar në bazë të indikacioneve mjekësore, e realizojnë të drejtën për pajisje ortopedike që mbulohen nga FSSHRMV dhe të njëjtat mund t'i sigurojnë nga ISHP (private) barnatoret dhe shtëpitë ortopedike që kanë marrëveshje aktive me Fondin. Në vitin 2019, të siguarit kanë mundur t'i sigurojnë pajisjet ortopedike nga 417 ISHP (private) barnatore / shitore të specializuara ortopedike.

Tabela nr.22 Marrëveshjet aktive për pajisjet ortopedike për vitin 2018, sipas rajonit

Rajoni	Nr. i marrëveshjeve
i Vardarit	33
Lindor	30
Jugperëndimor	30
Juglindor	29
i Pellagonisë	62
i Pollogut	32
Verilindor	24
i Shkupit	177
Totali	417

Burimi: FSSHRMV

Gjatë vitit 2019 janë dhënë diku rreth 233 mijë mjete ndihmëse prej të cilave pjesa më e madhe i takojnë grupit të mjeteve ortopedike. Sipas statistikës për mjete ortopedike të dhëna, mund të konstatohet se numri më i madh i mjeteve ortopedike i takojnë nëngrupit të mjeteve tjera dhe mjeteve sanitare ku bëjnë pjesë pelenat dhe qeset urostoma, ileostoma dhe kolostoma. FSSHRMV kryen analiza vjetore për mjeteve ortopedike të dhëna dhe të njëjtat i kemi paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr.23 Numri i pajisjeve të dhëna

Lloji i pajisjeve	2017	2018	2019
A Pajisjet ortopedike	156.245	153.032	179.551
1 Proteza	1.730	1.464	1.336
2 Aparat ortopedik – ortoza	19.785	23.397	23.690
3 Karroca për persona invalidë	2.433	4.731	3.007
Aksesorë të karrocave për persona invalidë	2.420	2.947	2.294
4 Këpucë ortopedike	5.280	9.016	6.852
5 Vata ortopedike – higjienike	611	791	433

6 Çorape elastike	115	251	142
7 Mjete ndihmese	11.541	12.557	17.137
8 Pajisje të tjera dhe pajisje sanitare	112.330	97.878	124.660
B- Pajisje për sytë	7.897	5.833	5.901
C -Pajisje për dëgjim	10.677	9.268	11.943
Ç- Pajisje për të folur me zë	18	11	19
D- Aparate teknike dhe protetike dentare	36.996	38.002	35.745
Korrigjime	131	130	119
Totali	211.964	206.276	233.278

Burimi: FSSHRMV

Fondi për sigurim shëndetësor mundëson realizimin e së drejtës për mjete ortopedike, duke ndanë mjete financiare të konsiderueshme. Mjetet ortopedike shfrytëzohen për zëvendësimin e pjesëve të caktuara trupore respektivisht për të korrigjuar deformimet e lindura ose të fituara. Qëllimi është të lehtësohet funksionimi i trupit në përditshmëri, po ashtu mjetet klasifikohen edhe si preparate në sanitari për qëllime mjekësore pa të cilat njeriu nuk mundet të bëjë jetë normale.

Gjatë vitit 2019, mjetet e përgjithshme financiare të ndara për mjetet ortopedike janë në vlerë prej rreth 549 milion denarë.

Tabela nr.24 Mjetet e ndara për pajisje ortopedike (në shumë prej 000 denarë)

Viti	Mjetet e paguara
2017	565.601
2018	576.449
2019	549.996

Burimi: FSSHRMV

6. TRAJTIMI MJEKËSOR JASHTË VENDIT

6.1 TRAJTIM MJEKËSOR JASHTË VENDIT ME VENDIM PREJ FSSHRMV-së

Në rast të një sëmundje që nuk mund të mjekohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, personi i siguruar mund të shfrytëzojë mjekim spitalor jashtë vendit me miratimin paraprak nga FSSHRMV-ja. Respektivisht, në raste të këtilla personi i siguruar udhëzohet për mjekim në vendin ku mjekimi i tij mund të ketë rezultat të suksesshëm.

Numri i kërkesave për mjekim jashtë vendit krahasuar me vitin e kaluar është zvogëluar nga 348 në 309, gjithashtu edhe numri i mjekimeve të kryera është zvogëluar nga 275 në 233 raste.

Tabela nr.25 Kërkesat për mjekim jashtë vendit

	2017	2018	2019
Totali i kërkesave	327	348	309
Mjekimet e kryera	219	275	233
Kërkesat e miratuara për mjekim të vazhdueshëm ose njohjen e shpenzimeve shtesë për mjekimin e miratuar paraprakisht	32	40	36
Kërkesa të refuzuara për shkak se nuk janë të pamjaftueshme mundësit për mjekim nëpër institucione shëndetësore të Republikës	68	33	40

Burimi: FSSHRMV

Personat e siguruar të cilëve kërkesa për mjekim jashtë vendit u është refuzuar nga ana e komisionit për mjekim jashtë vendit, për arsye se nuk janë të pamjaftueshme mundësitë për mjekim nëpër institucionet shëndetësore të Republikës ose për arsye se nuk kanë ekzistuar mundësi për mjekim të suksesshëm në vendet e huaja, kanë të drejtë të parashtrorin ankesë deri te komisioni i shkallës së dytë, respektivisht Bordi zgjedhor i Fondit për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr.26 Numri i lëndëve me ankesa, të parashtruara për mjekim jashtë vendit

	2017	2018	2019
Numri i lëndëve me ankesa të parashtruara për mjekim jashtë vendit	91	79	76
Numri i ankesave të pranuar	28	24	46
Numri i ankesave të refuzuara	63	55	30
Përqindja e ankesave të pranuar krahasuar me numrin e përgjithshëm të lëndëve	31%	30%	61%

Burimi: FSSHRMV

Tabela nr.27 Rastet më të shpeshta që udhëzohen për mjekim jashtë vendit

	2017	2018	2019
Syve	15	8	11
Kardiokirurgji të fëmijëve	16	13	9
Neurokirurgji	26	48	51
ORL	9	18	13
Kirurgji të fëmijëve	30	14	20
TOARIL	39	27	23
Urologji	15	3	6
Hematologji	36	29	5
Të tjera	33	115	95
Totali	219	275	233

Burimi: FSSHRMV

Tabela nr.28 Vendet ku më së shumti dërgohen të siguarit për mjekim jashtë vendit

3emja	2017	2018	2019
Turqi	87	112	104
Gjermani	37	38	18
Austri	12	26	15
R. e Maqedonisë së Veriut*	11	23	36
Serbi	20	20	21
Itali	9	18	7
Bullgari	13	10	8
Të tjera	3	9	6
Kroaci	9	6	12
Greqi	2	3	2
Sloveni	6	3	1
Zvicër	3	2	1
Britani e Madhe	2	2	0
Francë	2	2	2
Belgjikë	3	1	0
Totali	219	275	233

Burimi: FSSHRMV

*shërbimet e kryera në R. e Maqedonisë së Veriut janë shërbime brenda kornizave të marrëveshjes të cilat për shkak të evidencës dhe mënyrës së financave, përfshihen në kategorinë për mjekim jashtë vendit.

Pacientët më shumë udhëzohen të mjekohen në Turqi për intervenime neurologjike, intervenime që janë lëmi e klinikës TOARIL dhe QU (qendrës urgjente). Të siguarit që kanë sëmundje më të komplikuar udhëzohen në vende të Evropës Perëndimore ku posedojnë teknologji më të sofistikuar dhe nivelit të lartë të profesionalizmit të nevojshëm për t'i trajtuar këto pacient.

Tabela nr.29 Vlera e përgjithshme dhe mesatare e paguar për mjekim jashtë vendit

Viti	Numri i rasteve	Vlera e përgjithshme për mjekim jashtë vendit	Vlera mesatare për mjekim jashtë vendit
2017	219	401.696.000	1.834.228
2018	275	429.892.084	1.563.244
2019	233	415.012.644	1.781.170

Burimi: FSSHRMV

6.2 TRAJTIM MJEKËSOR JASHTË VENDIT PËR RASTE URGJENTE

Personat e siguar të cilët janë mjekuar si raste urgjente në institucionet shëndetësore të shteteve të huaja, gjatë qëndrimit të përkohshëm të tyre në atë vend, kanë të drejtë t'i kompensojnë shpenzimet e shërbimeve shëndetësore deri në momentin kur të largohet nga mjekimi urgjent, duke minusuar vlerën e participimit.

Urgjencën e rastit, kohëzgjatjen e emergjencës dhe shërbimet e nevojshme shëndetësore për të dalë pacienti nga rreziku që i kanoset për jetë, e vlerëson komisioni mjekësor i Njesisë rajonale të FSSHRMV-së në bazë të dokumenteve mjekësore që i dërgon institucioni shëndetësor i shtetit të huaj.

7. E DREJTA PËR REHABILITIM MJEKËSOR SI TRAJTIM I VAZHDUAR SPITALOR

Personi i siguruar mund ta realizojë të drejtën e rehabilitimit mjekësor të specializuar si mjekim i vazhduar spitalor me vendim të FSSHRMV-së atëherë kur pas mjekimit spitalor akoma ekzistojnë pengesa funksionale për largimit e të cilave është e domosdoshme të vazhdohet me mjekim dhe rehabilitim në spitalet e specializuara që ofrojnë shërbime të rehabilitimit mjekësor të specializuar. Këtë të drejtë të siguruarit mund ta realizojnë në ISHP (private) dhe ISHP (publike) banjat dhe institucionet mjekësore të specializuara për rehabilitim, që kanë marrëveshje me FSSHRMV-në

E drejta e rehabilitimit mjekësor të specializuar realizohet me vendim të FSSHRMV-së, pas përfundimit të mjekimit spitalor të sëmundjeve akute, gjendjes dhe lëndimeve ose pas përfundimit të mjekimit spitalor të sëmundjeve kronike të përkeqësuar, si dhe pas kontrollit specialistik/subspecialistik për paralizë cerebrale te fëmijët, sklerozë të shumëfishtë te shpërthimet gjysmë të rënda ose të rënda të sistemit lokomotor, plegjitë (hemiplegjia, paraplegjia dhe tetraplegjia), parezë të rënda, artriti reumatoid, sëmundjet onkologjike te fëmijët deri në moshën 18 vjeçare dhe hemofilia.

Dokumentet e nevojshme për ta realizuar këtë të drejtë janë: mendimi konziliar, fletë-lëshimi që dëshmon përfundimin e mjekimit spitalor dhe mendimi i komisionit mjekësor në kuadër të Fondit.

Rehabilitimi mjekësor i specializuar duhet të fillojë më së voni 2 muaj nga marrja e vendimit dhe mund të zgjasë më së shumti 21 ditë.

E drejta e rehabilitimit për sëmundjen ose lëndimin e njëjtë, mund të realizohet vetëm një herë brenda periudhës njëvjeçare nga data kur është përcaktuar ajo e drejtë. Nëse brenda periudhës njëvjeçare te personi i siguruar përsëritet lëndimi me shifrën e njëjtë të diagnozës sipas MKB 10, i siguruari mundet përsëri ta shfrytëzojë rehabilitimin mjekësor të specializuar brenda po atij viti.

Në rastet e paralizës cerebrale, te fëmijët e moshës deri trevjeçare, rehabilitimi mjekësor i specializuar mund të zgjasë deri në 30 ditë edhe atë deri në katër herë brenda një viti, ndërsa te fëmijët e moshës prej tre deri katërmbëdhjetë vjeçare, rehabilitimit mjekësor i specializuar mund të zgjasë deri në 30 ditë edhe atë dy herë brenda një viti.

Në vitin 2019, të drejtën e rehabilitimit mjekësor të specializuar si mjekim i vazhduar spitalor, me vendim të FSSHRMV-së, e kanë shfrytëzuar 5.382 persona të siguruar, ose diku rreth 8% më shumë se në vitin 2018.

Tabela nr.30 Numri i personave të siguruar të cilët e kanë realizuar të drejtën e rehabilitimit mjekësor

Viti	Numri i të siguruarve
2017	4.706
2018	4.973
2019	5.382

Burimi: FSSHRMV

Për ISHP (private, banjat) që kryejnë shërbime të rehabilitimit mjekësor si mjekim i vazhduar spitalor, në vitin 2019 FSSHRMV u siguroi buxhet në vlerë të përgjithshme prej 82.000.000 milion denarë. Buxheti që destinohet për rehabilitim mjekësor nëpër ISHP (publike), është i përfshirë në buxhetin e përgjithshëm vjetor të tyre, të përmendura më lartë.

Në vitin 2019, banjat kanë realizuar një llojllojshmëri më të madhe të shërbimeve shëndetësore se sa buxheti i përcaktuar respektivisht, për të njëjtën periudhë rreth 1,2 milion denarë.

Tabela nr.31 Vlera e realizuar për rehabilitim mjekësor nëpër banja, për vitin 2019

Institucionet shëndetësore	Buxheti për vitin 2019	Vlera e përgjithshme e realizuar	Pjesëmarrja e rehabilitimit mjekësor – specialistik në vlerën e përgjithshme	Vlera e përgjithshme e realizuar për	Pjesëmarrja e rehabilitimit mjekësor të specializuar në vlerën e përgjithshme	Vlera e përgjithshme e realizuar në vitin 2019
		Rehabilitim mjekësor		Për rehabilitim mjekësor specialistik si mjekim i vazhduar spitalor		
BANJAT E KATLLANOVËS – KATLLANOVË	27.000.000	7.949.729	29%	19.091.271	71%	27.041.000
ПЗУ СПЕЦ. БОЛ. ПО ФИЗ. МЕД. И BANJAT E DIBRËS - САРА	21.000.000	13.294.800	64%	7.600.200	36%	20.895.000
BANJAT E NEGORCIT - GJEVGJELI	9.500.000	6.999.120	65%	3.773.880	35%	10.773.000
AD "CAR SAMUL" – BANSKO, STRUMICË	24.500.000	8.732.640	36%	15.761.370	64%	24.494.010
Totali	82.000.000	36.976.289	44%	46.226.721	56%	83.203.010

Burimi: FSSHRMV

Nga ISHP (private) që kryejnë shërbime të rehabilitimit mjekësor si mjekim i vazhduar (banjat), në vitin 2019 fatura me vlerë më të lartë është realizuar nga "Banjat e Katllanovës" – edhe atë me vlerë rreth 27 milion denarë.

8. E DREJTA E REFUNDIMIT TË MJETEVE

Në pajtueshmëri me ligjin dhe aktet nënligjore, personi i siguruar ka të drejtë t'i refundojë mjetet në qoftë se nga institucioni shëndetësor përkatës nuk e merr shërbimin shëndetësor të kompletuar dhe për këtë arsye i siguruari është detyruar që barnat dhe materialet mjekësore t'i blejë jashtë institucionit shëndetësor.


Kusht për realizimin e kësaj të drejte është që personi i siguruar të ketë sigurim shëndetësor aktiv në momentin e kryerjes së shërbimit shëndetësor, t'i ketë të paguara kontributet shëndetësore në momentin e kryerjes së shërbimit shëndetësor si dhe institucioni shëndetësor përkatës të ketë marrëveshje aktive me Fondin.

Sipas akteve nënligjore të Fondit, të drejtën për refundimin e mjeteve i siguruari mund ta realizojë për:

- ❖ Barnat nga lista pozitive e barnave;
- ❖ Materiale mjekësore të harxhuara si dhe materiale që përfshihen në kujdesin shëndetësor spitalor
- ❖ Shërbime mjekësore të kryera në kujdesin shëndetësor specialistik - konsultativ dhe spitalor
- ❖ Harxhime për transport gjatë kryerjes së shërbimeve shëndetësore të dializës dhe shërbime për të shikimit, dëgjimit dhe të folurit
- ❖ Shërbime të kryera për dializë jashtë vendit
- ❖ Mjete ortopedike;

- ❖ Rehabilitim mjekësor të specializuar si mjekim spitalor i vazhduar.

Grafiku nr. 22 Numri i kërkesave për refundimin e mjeteve, në vitin 2019



Burimi: FSSHRMV

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 22.731 refundime për barnat e blera dhe 694 refundime për materialet mjekësore të blera.

Mjetet e paguara për refundim në vitin 2019 janë në vlerë prej 82 milion denarë, të cilat në krahasim me vitin 2018 përfaqësojnë rënie prej 30%.

Tabela nr.32 Mjetet e paguara për refundim

Viti	Vlera e paguar
2017	63.957.000
2018	63.309.727
2019	82.013.168

Burimi: FSSHRMV

9. E DREJTA PËR T'U LIRUAR NGA PAGESAT E PARTICIPIMIT (BASHKË-PAGESAT)

Personat e siguruar janë të detyruar të paguajnë participim gjatë kryerjes së shërbimeve shëndetësore dhe për barna. Gjithashtu, ata kanë të drejtë edhe të lirohen nga pagesa e participimit në qoftë se plotësojnë një nga kriteret për përcaktimit e vlerës maksimale. Në pajtueshmëri me aktet nënligjore, vlera maksimale që paguan një i siguruar në nivel vjetor është 70% nga paga mesatare neto e vitit të kaluar. Përveç këtij limiti, në aktet nënligjore janë të përcaktuara edhe limite me vlera më të ulëta prej 40% dhe 20% për personat që realizojnë të ardhura të ulëta, fëmijët dhe personat e moshës mbi 65 vjeçare. Nëse të siguruarit e kanë paguar participimin në vlerën maksimale, kanë të drejtë të parashtronë kërkojnë për t'u liruar nga participimi në bazë të vendimit që jepet nga FSSHRMV.

Lirimi nga participimi referohet për çmimet e shërbimeve shëndetësore të ofruara, përveç barnave nga Lista e barnave të kujdesit shëndetësor parësor, shërimi jashtë vendit, mjeteve ortopedike dhe mjeteve tjera.

Në vitin 2019 janë miratuar gjithsej 1.786 vendime për lirim nga participimi dhe refundim të mjeteve të paguara shtesë, gjë që paraqet rënie për 4% ose 74 vendime më pak në krahasim me vitin e kaluar.

Tabela nr.33 Numri i vendimeve për lirim nga participimi dhe refundimin e mjeteve të paguara shtesë

	2017	2018	2019
Lirimi nga participimi dhe refundimi i mjeteve të paguara shtesë	1.961	1.860	1.786

Burimi: FSSHRMV

Përveç lirimimit nga participimi pas arritjes së limitit vjetor, me rregulloren ligjore janë paraparë lirime nga participimi edhe për një kategori të veçantë të personave të siguruar dhe për një kategori të veçantë të shërbimeve, dhe atë:

- ❖ Personat e siguruar në kontroll mjekësor te mjeku amë dhe personat që i nënshtrohen ndihmës mjekësore emergjente nga thirrja paraprake;
- ❖ Shfrytëzuesit e ndihmës së përhershme financiare, personat e vendosur nëpër institucionet e kujdesit social dhe në bashkësi tjetër familjare, sipas rregullores për kujdesin social, përveç participimit të barnave me recetë që marrin pjesë në listën e kujdesit shëndetësor parësor dhe participimit për mjekimin jashtë vendit;
- ❖ Personat me aftësi të kufizuar mendore të shtrirë në spitalet psikiatrike dhe personat e retarduar (me zhvillim të vonuar mendor) që janë pa kujdesej prindërore;
- ❖ Fëmijët me nevoja të veçanta, sipas rregullores për kujdesin social;
- ❖ Sipas plan programit të Ministrisë së Shëndetësisë (dhuruesve të gjakut, fëmijëve deri në moshën 1 vjeçare, etj.);
- ❖ Pjesëmarrësit e LNÇ;
- ❖ Invalidët e luftës dhe familjarët e tyre;
- ❖ Personat e siguruar që kanë dhuruar gjak në bazë vullnetare, përmes programit për dhurimin e gjakut në pajtueshmëri me Ligjin për kujdesin shëndetësor;
- ❖ Personat e siguruar që cilët kanë dhuruar organe ose inde në bazë vullnetare.

III KOMPENSIMET

1. E DREJTA E KOMPENSIMEVE FINANCIARE

Në kuadër të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm, të siguruarit kanë të drejtë për kompensime financiare, edhe atë: për kompensimin e pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë për shkak të sëmundjes dhe lëndimit (pushimi mjekësor), për kompensimin e pagës gjatë shfrytëzimit të pushimit të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë (pushimi i lehonisë) dhe refundimet e shpenzimeve të udhëtimit gjatë përdorimit të shërbimeve shëndetësore.

Kushtet që duhet plotësuar për t'i realizuar të drejtat nga sigurimi shëndetësor janë:

- ❖ Sigurimi shëndetësor i personit të jetë aktiv më së paku 6 muaj pa ndërprerje, para fillimit të aplikimit të së drejtës në fjalë;
- ❖ Kontributet e sigurimit shëndetësor të jenë të paguara rregullisht ose me vonesë më së shumti deri në 60 ditë;
- ❖ Vlerësimin për ndërprerjen e përkohshme të punës ta japë mjeku amë respektivisht komisioni mjekësor.

Niveli i kompensimit financiar është 70% nga paga ose 85% nga paga për persona me sëmundje malinje. Niveli i kompensimit financiar është 100% nga paga në rast se lëndimi gjatë orarit të punës, sëmundjes profesionale; periudhës së dhurimit të gjakut në bazë vullnetare, indeve ose organeve; si, dhe gjatë pushimit të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë (lehonisë).

Vlera maksimale që i siguruari mund ta fitojë si kompensim të pagës është 4 paga mesatare.

Kompensimi për 30 ditët e para e paguan punëdhënësi, ndërsa mbi 30 ditë e paguan FSSHRMV. Kompensimet kur FSSHRMV i paguan nga dita e parë, janë: rastet e kujdesit ndaj fëmijës së sëmur deri në moshën trevjeçare; periudhës së dhurimit të gjakut në bazë vullnetare, indeve ose organeve; si, dhe gjatë pushimit të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë (lehonisë).

Viteve të fundit FSSHRMV ka ndërmarrë një sërë masash ashtu që pagesat e kompensimeve financiare sot të kryhen rregullisht dhe pa vonesë të panevojshme.

Më poshtë, nga tabela, vërehet se numri i pushimeve mjekësore ruan trendin e rritjes së vazhdueshme nga viti i kaluar.

Tabela nr.34 Numri i kompensimeve financiare për pushimet mjekësore dhe pushimet e lehonisë

Lloji i kompensimit	2017	2018	2019
Pushimi mjekësor	21.971	23.646	28.274
Pushimi i lehonisë	9.793	9.906	10.209
Totali	31.764	33.552	38.483

Burimi: FSSHRMV

1.1 E DREJTA E KOMPENSIMIT TË PAGËS GJATË PERIUdhËS SË PUSHIMIT MJEKËSOR

Në kuadër të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm, të sigurimeve u mundësohet e drejta e kompensimit të pagës gjatë periudhës së pushimit mjekësor. Në pajtueshmëri me ligjin, këtë të drejtë mund ta gëzojnë të siguarit që janë në marrëdhënie pune.

Në vitin 2019 janë realizuar gjithsej 28.274 të drejta për pushim mjekësor të cilat sipas dispozitës ligjore, të gjitha i mbulon FSSHRMV. Sipas kategorive, rritja më e madhe e pushimeve mjekësore është te sëmundjet profesionale dhe lëndimet gjatë orarit të punës me rrethe 26%, te kujdesi ndaj anëtarit ka një rritje me rreth 25%, ndërsa te pushimet mjekësore (për shkak të sëmundjes) ka një rritje prej 16%. Sipas strukturës, pjesëmarrja më e madhe është e pushimeve mjekësore (për shkak të sëmundjes) të cilat marrin pjesë me 64% dhe kujdesi ndaj anëtarit me 33%.

Tabela nr.35 Numri i kompensimeve për pushim mjekësor

Lloji i pushimit mjekësor	2017	2018	2019
Lëndimi gjatë orarit të punës dhe sëmundjes	834	784	986
Sëmundje	14.508	15.525	18.082
Kujdesi ndaj anëtarit të ngushtë të familjes	6.629	7.337	9.206
Totali i pushimeve mjekësor	21.971	23.646	28.274

Burimi: FSSHRMV

Pjesa më e madhe e kompensimeve u takojnë të siguarve të rajonit të Shkupit, për arsye se kanë më shumë të siguar që janë në marrëdhënie pune aktive.

Në vitin 2019, vlera më e lartë sipas treguesit të pushimit mjekësor, për 1.000 punonjës të siguar, është në rajonin e Vardarit me një vlerë prej 65, ndjekur nga rajoni Lindor me 63 dhe rajoni i Shkupit me 56. Vlera më e ulët është në rajonin e Pollogut dhe Verilindor me 29.

Tabela nr.36 Pushimet mjekësore sipas rajonit për vitin 2019

Rajoni	Lëndimi gjatë orarit të punës dhe sëmundjes profesionale	Sëmundjet	Kujdesi ndaj anëtarit	Totali	Numri i të siguarve	Numri i pushimeve mjekësore në 1.000 punëtorë të siguar
i Vardarit	97	1.764	1.165	3.026	46.605	65
Lindor	137	2.289	1.050	3.476	55.210	63
Jugperëndimor	71	1.388	375	1.834	48.125	38
Juglindor	60	1.645	449	2.154	42.409	51
i Pellagonisë	153	2.152	524	2.829	67.265	42
i Pollogut	41	1.005	342	1.388	47.140	29
Verilindor	44	796	132	972	33.463	29
i Shkupit	383	7.043	5.169	12.595	223.675	56
Totali	986	18.082	9.206	28.274	563.892	47

Burimi: FSSHRMV

Në nivel shtetëror, në çdo 1.000 punëtor të siguar, 47 të siguar kanë shfrytëzuar të drejtën e pushimit të mbuluar nga ana e FSSHRMV-së, e cila krahasuar me vitin 2018 kur koeficienti ishte 38 është një rritje prej 9 pikësh dhe është për shkak të numrit të shtuar të pushimeve mjekësore.

Në vitin 2019 kemi rritje sa i përket vlerës që paguan FSSHRMV për këtë qëllim, e cila padyshim ka të bëjë me pagesën e rregullt të pushimeve mjekësore. Shpenzimet për pushimet mjekësore në vitin 2019 shënojnë rritje prej 15% ose rreth 111 milion denarë.

Tabela nr.37 Mjetet e paguara për pushimet mjekësore

Viti	Mjetet e paguara për pushimet mjekësore
2017	691.286.000
2018	756.682.000
2019	868.316.139

Burimi: FSSHRMV

1.2 KOMPENSIMET E PUSHIMIT TË LINDJES

Në pajtueshmëri me Ligjin për Sigurimin Shëndetësor, të siguruarat kanë të drejtë për kompensim të pagës për mungesën në punë gjatë periudhës së shtatzënisë, lindjes së fëmijës dhe amësisë (lehonisë). Ky kompensim që nga viti 2012 mbulohet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa procedurën administrative e kryen FSSHRMV.

Në krahasim me vitin 2018, numri i përgjithshëm i pushimeve të lindjes është rritur me rreth 3%. Në këtë mënyrë, ekziston një rritje prej 6% për gratë e siguruar që u kthyen në marrëdhënie pune më herët se 9 muajt e planifikuar të pushimit të lindjes, dmth që përdorën të drejtën për të marrë gjysmën e pushimit së përcaktuar të lehonisë përveç pagës. Në vitin 2019, 63 meshkuj e kanë realizuar të drejtën e kompensimit për pushimin e lindjes.

Tabela nr.38 Numri i kompensimeve për pushimin e lehonisë

	2017	2018	2019
Shtatzëni dhe lehoni	9.323	9.628	9.913
Lehonat në marrëdhënie pune	470	278	296
Totali i lehonave	9.793	9.906	10.209

Burimi: FSSHRMV

Sipas shpërndarjes së të drejtave, pjesa më e madhe në vlerë absolute shpërndahet në rajonin e Shkupit me 42% nga numri i përgjithshëm i pushimeve të lindjes në vend.

Në vitin 2019, numri i të drejtave të dhëna për 1.000 të siguruar është 40 dhe është afërsisht në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Vlera më e lartë e këtij treguesi është në rajonin e Pollogut me 50 pikë dhe korrespondon me shkallën e lartë të lindjeve në këtë rajon. Shkalla më e ulët është në rajonin Lindor, në çdo 1.000 të siguruar, janë dhënë 34 të drejta për pushimin e lindjes.

Tabela nr.39 Kompenimet për pushimet e lindjes për vitin 2019, sipas rajonit.

Rajoni	Shtatzënia dhe lehonat	Lehonat në marrëdhënie pune	Numri total i lehonave	Numri i femrave të punësuar	Numri i lehonave në 1.000 femra të punësuar
i Vardarit	733	21	754	21.501	35
Lindor	890	26	916	27.050	34
Jugperëndimor	869	32	901	20.652	44
Juglindor	753	19	772	19.092	40
i Pellagonisë	1.092	35	1.127	31.342	36
i Pollogut	847	46	893	17.791	50
Verilindor	541	20	561	14.690	38
i Shkupit	4.188	97	4.285	101.762	42
Totali	9.913	296	10.209	253.880	40

Burimi: FSSHRMV

Trendi i rritjes së numrit të pushimeve të lehonisë korrespondon edhe me rritjen e mjeteve financiare. Në tabelën në vijim do të vërejmë se vlera e mjeteve financiare në vitin 2019 shënon rritje prej 5% ose 122 milion denarë në krahasim me vitin 2018.

Tabela nr.40 Mjetet financiare të paguara për pushimin e lindjes

Viti	Mjetet e paguara për pushimin e lindjes
2017	2.301.613.000
2018	2.499.202.000
2019	2.621.223.847

Burimi: FSSHRMV

1.3 E DREJTA E UDHËZIMIT NË KOMISIONIN INVALIDOR NË RASTË TË TEJZGJATJES SË PUSHIMIT MJEKËSOR

Në rast të tejzgjatjes së pushimit mjekësor deri në 12 muaj, komisioni mjekësor i shkallës së parë në kuadër të FSSHRMV-së, e udhëzon të siguruarin në komisionin invalidor që funksionon në kuadër të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor (KRM)⁴ të vlerësojnë aftësinë e punës së të siguruarit në fjalë.

Gjatë vitit 2019, komisioni mjekësor i FSSHRMV-së drejt komisionit invalidor KRI⁵ ka udhëzuar 640 të siguruar për të vlerësuar aftësinë për punë të tyre.

Tabela nr.41 Numri i të siguarve që janë udhëzuar drejt komisionit për të vlerësuar aftësinë punuese të tyre.

	2017	2018	2019
Numri i përgjithshëm i personave të udhëzuar në komisionin invalidor për vlerësimin e aftësive për punë KRI	1.081	566	640

Burimi: FSSHRMV

⁴ Sqarim KRM – Komisioni Republikan i Maqedonisë

⁵ Sqarim: KRI - Komisioni Republikan Invalidor

IV VEPRIMTARIA E FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETËSOR

1. ANALIZA E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE – FINANCIARE NË FONDIN PËR SIGURIM SHËNDETËSOR PËR VITIN 2019

1.1 BUXHETI I FSSHRMV-së KRAHASUR ME VITET E KALUARA DHE NË RAPORT ME VENDET E TJERA

Buxheti i FSSHRMV-së për vitin 2019, i planifikuar me rebalancin e buxhetit të RMV-së në muajin tetor të vitit 2019, shkon në 31,5 miliard denarë.

Tabela nr.42 Buxheti i FSSHRMV-së për vitin 2019 (në 000 denarë)

	Vlera
Buxheti i planifikuar	31.465.200
Buxheti i planifikuar në fund të vitit	31.276.781

Burimi: FSSHRMV

Realizimi në fund të vitit ka qenë në vlerë prej 31,3 miliardë denarë, i cili në krahasim me buxhetin e planifikuar është realizuar 99,4%.

Tabela nr.43 Buxheti i FSSHRMV-së në raport me vitin e kaluar, buxhetin e RMV-së dhe BPV

Viti	Shpenzimet e përgjithshme të FSSHRMV-së	% e ndryshimit të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar	Buxheti i FSSHRMV-së si % në buxhetin e RMV-së	Buxheti i FSSHRMV-së % nga BPV
2014	22.570.530.244	3,12%	13,43%	4,28%
2015	24.119.778.640	6,86%	13,35%	4,32%
2016	26.030.571.823	7,92%	14,04%	4,35%
2017	27.494.135.748	5,62%	13,52%	4,36%
2018	29.406.375.112	6,96%	13,97%	4,47%
2019	31.276.781.266	6,36%	13,70%	4,48%

Burimi: FSSHRMV dhe Ministria e Financave

Duke e analizuar buxhetin e FSSHRMV-së në 6 vitet e fundit, i njëjti lëviz nga 22,6 miliard denarë në vitin 2014 në 31,3 miliard denarë në vitin 2019. Gjegjësisht, është konsumuar rritje e mjeteve (në vlerë absolute) të cilat i posedon FSSHRMV. Buxheti në vitet e shënuara në tabelën më lartë, për vitet e përmendura shënojnë rritje mesatare prej 1.741 milion denarë për çdo vit. Rritja intensive është në vitin 2016 edhe atë prej 7,92%.

Duke e sistematizuar buxhetin e FSSHRMV-së si përqindje e buxhetit të RMV-së, lëvizja në periudhën e viteve 2014-2019 është mes 13,55% dhe 14,04%. Në vitin 2019 vlera e këtij treguesi shënon 13,7%.

Njëkohësisht, nëse krahasojmë buxhetin e FSSHRMV-së në raport me BPV, në periudhën e viteve 2014-2019 vlera e këtij treguesi në vitin 2019 lëvizin mes 4,28% dhe 4,48%.

1.2 TË ARDHURAT

Gjatë vitit 2019, së bashku me të ardhurat e transferuara nga viti paraprak, janë realizuar të ardhura në vlerë totale prej 31.970,8 milion denarë, përkatësisht të ardhura mesatare mujore prej 2.664 milion denarë. Të ardhurat e përgjithshme në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 kur kanë qenë 29.798,7 milion denarë, janë rritur për 2.172 milion denarë ose për 7,3%.

Tabela nr.44 Struktura e të ardhurave të realizuara të FSSHRMV-së në vitin 2019 (të shprehura në 000 denarë)

Të ardhura	Të ardhurat e realizuara në vitin 2019
TOTALI:	31.970.832
TË ARDHURAT E TATUESHME	28.387.234
Kontribute nga paga për fondet sociale	28.387.234
Kontribute nga bruto paga dhe kontributet	17.623.511
Kontribute prej APRMV	145.304
Kontribute prej PIOMV	7.437.427
Të ardhurat prej MSH (kontribute për personat e pasiguruar)	3.054.199
Të ardhurat prej MPPS (kontribute)	126.793
TË ARDHURAT E PA TATUESHME	529.749
Të ardhura tjera të pa tatueshme	529.749
Të ardhurat tjera prej participimit	442.831
Të ardhura të tjera	86.918
TRANSFERET DHE DONACIONET	3.053.849
Transferim prej niveleve tjera qeverisëse	3.053.849
Të ardhura prej MPPS (pushimet e lehonisë)	2.661.539
Transferimi i tepicës së të ardhurave prej viti të kaluar	392.310

Burimi: FSSHRMV


Të ardhurat e planifikuara, në pajtueshmëri me rebalancimin e buxhetit të RMV-së, në muajin tetor të vitit 2019 janë në vlerë prej 31.465 milion denarë. Të ardhurat e realizuara në krahasim me ato të planifikuara janë 101,61%.

Pjesën më të madhe në strukturën e të ardhurave të FSSHRMV-së e zënë të ardhurat e tatueshme (kontributet nga paga për fondet sociale) me 88.8%, transferimet nga MPPS për pushimet e lehonisë me 8.32% dhe të ardhura tjera të pa-tatueshme së bashku me bartjen e tepicës së të ardhurave prej vitit të kaluar me 2.88%. Në krahasim me strukturën e vitit 2018, tek të ardhurat e tatueshme vërehet rritje prej 0,2%.

Është e rëndësishme të kemi parasysh se përveç kontributeve të pagave, për një kategori të të siguruarve, kontributet i paguajnë disa institucione shtetërore, edhe atë:

- ❖ Për personat e papunë që realizojnë të ardhura – Agjencioni për punësim;
- ❖ për të siguarit që e gëzojnë të drejtën sociale – Ministria për Punë dhe Politikë Sociale;
- ❖ për pensionistët – Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor;
- ❖ për të pasiguarit – Ministria e Shëndetësisë.


Grafiku nr. 23 Struktura e të ardhurave



Burimi: FSSHRMV

Grafiku tregon realizimin e të ardhurave sipas muajve, në vitin 2019, së bashku me tepricën e transferuar nga viti 2018. Sipas grafikut, gjenerimi më i lartë i të ardhurave ishte në korrik prej 3.122 milion denarë, dhe të ardhurat më të ulëta ishin në qershor prej 2.261,7 milion denarë.

Grafiku nr. 24 Të ardhurat për secilin muaj (në 000 denarë)




Burimi: FSSHRMV

1.2.1 TË ARDHURAT NGA KONTRIBUTET E PAGAVE

Të ardhurat në vitin 2019 shënojnë rritje në krahasim me vitin 2018, respektivisht të njëjtët prej 16.130,7 milion denarë janë rritur në 17.623,5 milion denarë ose me 9,25%.

Grafiku nr. 25 Të ardhurat nga kontributet e pagave (në 000 denarë)



Burimi: FSSHRMV

Në strukturën e kontributeve, pjesa më e madhe me 14.836,5 milion denarë, ose rreth 84,2%, i takon kontributit të personave të punësuar në mënyrë aktive. Pas tyre, me 6% ose 1.053 milion dhe 5% ose 880,4 milion, marrin pjesë kontributet nga kontributi shtesë dhe kontributet nga vitet e mëparshme.

Grafiku nr. 26 Struktura e kontributeve të pagave



Burimi: FSSHRMV

